



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 32/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e Shtabit Zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, në seancën e mbajtur më datë 2.11.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Shtabi Zgjedhor i PDK-së, dega në Prishtinë, ka parashtruar një ankesë me të cilën pretendon se me datë 14.10.2009, kandidati për këshilltar në listën e LDK-së për Kuvendin Komunal, z. Mentor Morina bashkë me një grup aktivistësh të LDK-së i ka shqyer të gjitha posterët e kandidatit për Kryetar nga radhët e PDK-së, z. Astrit Salihu në pjesët e ndryshme të qytetit të Prishtinës.

FAKTET

Më 26 Tetor 2009, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë nga Shtabi Zgjedhor i PDK-së - dega në Prishtinë, ne të cilën theksohet se janë shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet Lokale Nr.03/L072, akteve të aprovuara nga KQZ si dhe Kodi Etik për Fushatë Zgjedhore, sepse më 24.10.2009, kandidati për këshilltar në listën e LDK-së për Kuvendin Komunal, z. Mentor Morina bashkë me një grup aktivistësh të LDK-së i ka shqyer të gjitha posterët e kandidatit për Kryetar nga radhët e PDK-së, z. Astrit Salihu në pjesët e ndryshme të qytetit të Prishtinës.

Ankesës i është bashkangjitur vetëm një fotografi nga vendi i supozuar, ku posterat e kandidatit për kryetarë të komunës së Prishtinës, z. Isa Mustafa, janë të vendosura mbi posterat e kandidatit për kryetar të kësaj komunë, z. Astrit Salihu.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e nenëve 3.6 pika (b) dhe pika (c), përkatësisht një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar si dhe hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 32/2009 më datën 2.11.2009.

